

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve A.W.V.A.G.-G.-S...., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit I.A.L.L.C, me seli në P., respektivisht me B.N. avokat nga P., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.”, me seli në P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit F.C. nga P., me objekt kontesti shpërblim dëmi-regres në shumën e përgjithshme prej 13.705,56 euro, pas përfundimit të seancës kryesore publike të datës 11.09.2017, në prani të autorizuarit të paditëses dhe të paditurës, pas marrjes së fjalëve përfundimtare nga palët në procedurë, ndërsa me datë 19.09.2018 merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve A.E. V. A., G.1-G.2-S.

I.DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S.”, me seli në P., që paditëses t’ia paguaj në emër të shpërblimit të dëmit-kasko regresit, shumën e përgjithshme prej 11.273,62 euro (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tri euro e gjashtëdhjetë e dy cent), me kamatë ligjore prej 12%, duke llogaritur nga data 01.04.2016, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin parativ prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II.DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensoj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 2,532,00 euro, në afatin kohor prej 7 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve A.E. V. A., G.1-G.2-S., ka paraqitur padi pranë kësaj Gjykate për shpërblimin e dëmit kasko-regres të pësuar nga aksidenti i komunikacionit me datë 07.10.2015, për çka edhe ka kërkuar nga gjykata t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 13.705,56 euro, me kamatë ligjore prej 12 % duke filluar nga data 01.04.2016, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.”, me seli në P..

I autorizuari i paditëses pas marrjes së mendimit dhe konstatimit të ekspertit të komunikacionit dt.07.05.2018 dhe të makinerisë S.B. të datës 08.05.2018 dhe sqarimeve shtesë në seancën e datës 19.06.2018, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe atë për në emër të dëmit material shumën prej 10.800,00 CHF, duke e zbritur mbeturinat e shitura të automjetit prej 2.100,00CHF që rezultojnë vlerësimi i dëmit total prej 8.700.00CHF, në emër të shpenzimeve të transportit të automjetit të dëmtuar në shumë prej 2.055,20 CHF si dhe shpenzimet për automjetin me qira në shumë prej 2.000,00CHF, gjithsej shumën prej 12.755,20 CHF, respektivisht 11.302,81euro të konvertuar sipas kursit valutor të datës 11.09.2018 të gjitha këto me kamatë vonesë prej 12 % duke filluar nga data 01.04.2016, e deri në pagesën definitive, duke shtuar se me datën 07.10.2015, të suguruait të paditësit “P.C.E.R.” i është shkaktuar dëm në automjetin e markës “VW Touareg” me targa Z., këtë aksident e shkaktonte i siguruari i të paditurës auto kasko me datën 26.02.2016 zdemton të siguruarin e tij dhe me të drejtë në subrogim pretendon rimbursim në shumën prej 14.855,20 CHF në emër të dëmit total në automjet dhe shpenzimet e bartjes së automjetit në Zvicër, andaj edhe ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e tij ta aprovoi në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I autorizuari i të paditurës përmes përgjigjes në padi si dhe gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadsisë dhe lartësinë e kërkesëpadsisë, duke shtuar se rasti ka ndodhur në Kosovë me datën 07.10.2015 dhe se pronari i automjetit ka paraqit kërkesë për kompenzimin e dëmit të e paditura dhe së bashku me ekspertët e saj kanë bërë evidentimin e pjesëve të dëmtuara në automjet ku akteskupertizën e ka nënshkruar e dëmtuari N.R. po ashtu i njëjti automjetin e dëmtuar e ka dërguar te servisi VW B. A. , me pas e ka larguar automjetin nga servisi për të përfituar nga baza e policës kasko, kështu që procedura e kompenzimit të dëmit ka filluar të e paditura sipas të gjitha kriterëve ligjore të Ligjit mbi Sigurimin të Detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe me angazhimin e gatishmërisë e së paditurës që detyrimin për kompenzim dëmi t'a kryej në bazë të këtyre dispozita ligjore, por që këtë detyrim pengohet t'a kryej me ikjen e pajustificushme të palës së dëmtuar , duke tërheqë automjetin nga servisi me qëllim të caktuar ,dhe ka propozuar gjykatës që kërkesëpadsinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar mbi ofertat e ofruara.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Për zgjidhjen e kësaj çështje juridike Gjykata i administroi provat e propozuara nga palët në procedurë dhe atë duke filluar nga: polica e sigurimit auto kasko me nr...., pagesa e dëmit të auto kasko e dt.26.02.2016, foto dokumentacionet, librezat e qarkullimit të automjetit me targa ..., foto dokumentacionet e automjetit të dëmtuar , ekspertiza audio tex dt.09.02.2017, ekspertiza e ekspertit E.S., akt zhdëmtimi i dt.04.11.2015, në origjinal dhe përkthim,fatura e dt.22.10.2015 për transportin e automjetit në Zvicër, fatura dt.03.12.2015, rapoti i qendrës informative të BKS, për sigurimin e TPL dt.23.03.2016, korospendenca e palëve në procedurë, ekspertiza e komunikacionit dt.07.05.2018 e punuar nga eksperti S.B. dhe ekspertiza e makineris e punuar eksperti S.B. dt.08.05.2018, aktvlerësimi i dëmit dt.09.10.2015, njoftimi i dt.09.10.2015, shkresat elektronike dt.10.10.2015, kërkesa e dëmshpërmbimit.

Provat e propozuara dhe të administruara, deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse dhe ekspertizën gjyqësore, gjykata i vlerësoi, të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të LPK-së, dhe gjeti se:

Në mesë palëve në procedurë ishte baza juridike e kërkespadsisë lidhur me përgjegjësin e aksidentit si dhe lartësia e dëmit .

Gjykata me propozimin e të autorizuarit të palës paditëse ka nxjerr ekspertizën e komunikacionit për të vërtetuar shkaktarin e aksidentit nga eksperti i komunikacionit Sejdi Berisha i cili në ekspertizën e datës 07.05.2018, ka konstatuar se sipas analizave të rastit të dy automjetet kanë qenë duke lëvizur në të njëjtën rrugë, në drejtim të njëjtë por me kahe të kundërta.Automjeti “A”(kamioni) i cili ishte me ngarkesë (agregat)ishte duke lëvizur nga drejtimi i Prishtinës në drejtim të Ferizajit, dhe kur ka arritur në f.sh K. KK Lipjan,duke lëvizur me ngarkesë të pa siguruar, i është rrezuar ngarkesa nga rimorkio në rrugë,në përballkalim ka qenë duke lëvizur automjeti “B” dhe ngarkesa e ngurt që është rrezuar nga rimorkio e automjetit “A”e ka goditur automjetin “B” në anën e pasme të majtë kështu deri te aksidenti kishte ardhur si pasojë e ngasësit të automjetit “A” të kishte siguruar (përforcuar) ngarkesën e vendosur në mënyrë që mos të rrezikoj komunikacionin,andaj ky ngasës “A” nuk e ka siguruar ngarkesën e as nuk e ka monitoruar gjatë udhëtimit, kështu që ka shkaktuar aksidentin me dëmë materiale.

Po ashtu gjykata ka nxjerrë provën edhe me ekspertizë të makinerisë për ta vërtetuar lartësinë e dëmit, ku sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertizës së makinerisë të datës 08.05.2018 nga eksperti Sejdi Berisha dhe sqarimeve shtesë në seancën e datës 19.06.2018, ka vërtetuar faktin se automjeti “VW Touareg”(2005) me targa Zvicërrane ..., ka pasur dëmtime

materiale të mëdha të cilat dëmtime janë shkaktuar me rastin e goditjes së automjetit nga automjeti që ka shkaktuar aksidentin.

Eksperti në ekspertizën e tij të hartuar me shkrim ka theksuar se vlera e automjetit në kohën e aksidentit arrin shumën prej 10,800.00 CHF, ndërsa duke e zbritur vlerën e pjesëve të mbetura nga dëmi total në automjet shumën prej 2,100.00CHF arrin shumën prej 8,700.00 CHF pasi që vlera e riparimit të automjetit tejkalon vlerën e automjetit i njëjti konsiderohet si dëm total ekonomik dhe riparimi është i pa arsyeshëm, vlera e përgjithshme arrin shumën prej 8,700.00 CHF.

Po ashtu nga fatura e datës 22.10.2015 për transportin e automjetit në Z. dhe nga konfirmimi i pagesës gjykata ka vërtetuar faktin se është paguar nga paditësi shuma prej 2,055.20 CHF, si dhe nga fatura e datës 03.12.2015 për marrjen me qira të automjetit të dëmtuar gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka paguar shumën prej 2,000.00 CHF.

Gjykata përcaktimin e lartësisë e vërtetojë sipas konstatimit të ekspertit pasi që i njëjti vlerësimin e lartësisë së dëmit e kishte bërë duke marr për bazë shkresat të cilat gjinden në lëndë dhe në bazë të këtij dokumentacioni për vlerësimin e çmimeve të pjesëve të mbetura nga dëmi total në automjet si dhe vlera reale e automjetit në kohën e aksidentit me shkallën e amortizimit, po ashtu gjykata ka gjetur se në emër të dëmit material në automjet është shuma prej 8,700.00 CHF, kurse sipas faturave dhe konformimeve të pagesave shumën prej 2.055.20 CHF në emër të transportin e automjetit në Z. dhe për marrjen me qira të automjetit të dëmtuar shuma prej 2.000.00 CHF, gjithsej shumën e përgjithshme prej 12.755,20 CHF.

Gjykata në bazë të kursit valutor të XE Currency Converter të datës 11.09.2018, ka konstatuar se në të njëjten datë 1 CHF, ka qenë e barasvlefshme me 0.88 euro. Kjo do të thotë që shuma prej 12.755,20 CHF, është e barasvlershme me 11.273,62 euro, andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse nga provat e administruara u vërtetua se paditësja ia ka kompensuar të siguarit të saj kompensimin e dëmit ndërsa po ashtu u vërtetua se i siguruari i të paditurës ishte shkaktar i dëmit, gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 136 paragrafi 1 të LMD-së, në të cilin thuhet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, andaj mbi gjendjen faktike të vërtetuar gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e drejtë dhe e bazuar andaj të njëjtën e ka aprovuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në kontekstin e përgjithshëm të procedurës provuese, duke vlerësuar pretendimet e paditësit, respektivisht të autorizuarit të tij dhe kundërshtimet e të autorizuarit të paditurës, gjykata ju referua nenit 960 paragrafi 1 të LMD-së, sipas të cilit *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguresin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”*. Meqenëse nga provat e administruara u vërtetua se paditësja ia ka kompensuar të siguarit të saj kompensimin e dëmit ndërsa poashtu u vërtetua se i siguruari i të paditurës ishte shkaktar i dëmit, gjykata duke u bazuar në dispozitën e sipërcituar dhe mbi gjendjen faktike të vërtetuar ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të autorizuarit të paditurës se vlerësimi i dëmit në automjetet duhet të bëhet sipas çmimeve të Kosovës me që i dëmtuari vetëm i është nënshtruar procedurës për kompensim tek e paditura ,por gjykata ka gjetur se në bazë të nenit 8 paragrafi 2 pika g të *“Rregullorës mbi procedurat e trajtimit të kërkesave për kompensimin e dëmeve që rrjedh nga sigurimi i detyrueshëm nga autopërgjegjësia”* (e datës 27.10.2012) e BQK-së, thuhet *“se dëmi në mjetin motorik të dëmtuar me targa të huaja mund të pranohet në bazë të faturës së riparimit të bërë në vendin e regjistrimit të mjetit motorik duke bërë*

krahasimin e atij riparimi me procesverbalin mbi dëmin”, andaj nga të lartë cekuarat gjykata e refuzoj si të pabazuar një pretendim të tillë.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe pretendimin tjetër të autorizuarit të palës së paditur lidhur me atë se llogaritja e dëmit është bërë pa u vërtetuar faktet se ato pozicione janë dëmtuar respektivish kanë shkallën të dëmtimit që riparohen apo duhen të ndërrohen si dhe eksperti nuk ka vlerësuar aktekspertizën e lëshuar nga e paditura, gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar për shkak se palët në procedurë kanë parashtruar pyetje për ekspertin e makinerisë i cili ka qenë prezent në seancën e datës 19.06.2018 dhe po në atë seanca e paditura e ka paraqit aktekspertizën e tij dhe i njëjti i është përgjigjur lidhur me vërejtjet me rastin e shqyrtimit të kësaj çështje civile-juridike, andaj mbi këto arsye gjykata edhe vendosi me aktvendim të refuzoj propozimin e të autorizuarit të palës së paditur për caktimin e ekspertizës së re të makinerisë me të cilën ka vlerësuar se nuk ka pas asnjë arsye që të angazhoj një ekspert tjetër.

Lidhur me vendosjen për pagesën e kamatës vjetore prej 12 % gjykata është bazuar në nenin 26 të Ligjit mbi sigurimin nga auto-përgjegjësia Nr. 04/L-018 e datë 23.06.2011 ndërsa lidhur me vendosjen për afatin paritiv për pagesë në afatin kohor prej 7 ditëve gjykata e ka bazuar në nenin 509 pika e të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 lidhur me nenin 463 paragrafi 1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurës, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi, dhe atë: taksën për padi shumën prej 100,00 euro, për ekspertizën e makinerisë shumën prej 150.00 euro, për ekspertizë të komunikacionit shumën prej 150.00 euro, për përkthim shumën prej 91,70euro, përpilimin e padisë shumën prej 416.00 euro, në emër përfaqësimit në tri seanca (3x540,80 euro-rritje me element të huaj 100%) shumën prej 1,622,40 euro, gjithsej në shumë të përgjithshme prej 2,532,00 euro.

Pas shqyrtimit të të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës gjykata ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 960 par. 1, nenin 136 par. 1 të LMD-së 04/L-077, si dhe në nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti Për Çështje Ekonomike
III.EK.nr.253/17 me datën 19.09.2018

Gjyqtarja
Franciska Zhitia Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, llogaritur nga dita e pranimit të të njëjtit, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.